

# NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDRËVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#101

## TAKIMI/ Ministri Majko me Grubin: Bashkë për të nxitur Diasporën të regjistrohet në Censur



Ministri i Shtetit për Diasporën, Z. Pandeli Majko priti sot në takim zëvendëskryeministrin e parë të Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi. Në takim u fol për rëndësinë e regjistrimit të popullsisë në Maqedoninë e Veriut dhe u theksua rëndësia që ka përfshirja sa më e madhe e Diasporës shqiptare në këtë proces. Zv/kryeministri Grubi u shpreh se kush më mirë se Ministri Majko mund të luaj një rol kyç për të ndihmuar në regjistrimin e mërgatës së Maqedonisë së Veriut, duke sjell në vëmendje gjithashtu kontributin e Ministrisë Majko gjatë luftës së Kosovës.

Ministri Pandeli Majko në thirrjen e tij drejtuar Diasporës, vuri theksin te rëndësia e këtij procesi, një proces që do të japë mundësi shqiptarëve në Maqedoni të përdorin gjuhën dhe flamurin e tyre kombëtarë.



## "Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

## VOTA E DIASPORËS/ Majko: Opozita kundër, e konsideroi sukses te maxhorancës

Ministri i Diasporës Z. Pandeli Majko duke folur për votën e diasporës ka deklaruar se janë bllokuar aktet nënligjore, të nevojshme për këtë proces. Ministri Majko thekson se opozita e konsideroi aplikimin një sukses të maxhorancës, duke shtuar se sërish ky proces do të ndiqet, e nuk do të lihet në mes. Ai nënvizon se maxhoranca do që të krijojë një qark elektoral vetëm për Diasporën. Këto deklarata ai i bëri në emisionin "Front line" në "News 24" nga gazetarja Marsela Karapanço.



## Vota e Diasporës Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

## CENSUSI/ KKD apel Diasporës së Maqedonisë së Veriut për regjistrim



Këshilli Koordinues i Diasporës, nëpërmjet një deklarate publike mbrëmjen e sotme i ka bërë apel mërgatës nga Maqedonia e Veriut të bëhet pjesë e regjistrimit të popullatës.

"Të nderuar pjesëtarë të Diasporës sonë nga Maqedonia e Veriut, ne si Këshill Koordinues i Diasporës (KKD), Ju bëjmë thirrje të gjithë Juve në çdo vend të botës, kudo që ndodheni, – Bëhuni pjesë e regjistrimit të popullatës në Maqedoninë e Veriut. Regjistrimi i popullatës në këtë vend tashmë ka hyrë në fazën thelbësore kur pa përjashtim të gjithë Ju duhet të bëheni pjesë e këtij procesi që përfundon më 21 prill", thuhet në deklaratë.



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"




## Diaspora Shqiptare

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS

App store: këtu Play store: këtu

## Digjitalizimi i Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online